



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME

2024:034719

Numri i lëndës:

Datë: 19.07.2024

Numri i dokumentit: 05959250

PML.nr.446/24

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Agim Maliqi, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Sherif Krasniqi, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të pandehurit I. I., nga P., për shkak të veprës penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit I. I., për mbrojtje të ligjshmërisë, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda, Ppr.kr.nr.14/2024 i datës 27.05.2024, dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PN.1.nr.638/2024 të datës 04.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 17.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet si e papranueshme kërkesa e mbrojtësit të të pandehurit I. I., për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda, Ppr.kr.nr.14/2024 të datës 27.05.2024, dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PN.1.nr.638/2024 të datës 04.07.2024.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti për Krime të Rënda Ppr.kr.nr.14/2024 të datës 27.05.2024, të pandehurit I. I., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së i ka vazhduar masën e arrestit shtëpiak prej 1 (një) muaj dhe atë deri më 29.06.2024. Masa e arrestit shtëpiak të pandehurit i është vazhduar në bazë të neni 181, lidhur me nenin 184, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 dhe 1.2 pika 1.2.2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda me aktvendimin PN.1.nr.638/24 të datës 04.07.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të pandehurit I. I. dhe e ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të pandehurit I. I., avokati Driton Muharremi nga P. për shkak të shkeljeve të dispozitave nga neni 184, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 pika 1.2.2 të KPP-së, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 432, paragrafi 1 dhe 4 lidhur me nenin 384, paragrafi 2 pika 2.1 dhe 2.2 të KPP-së, shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, t`a aprovoj kërkesën e mbrojtjes dhe të konstatoj se aktvendimet e atakuara me kërkesë janë marrë me shkelje KPP-së dhe shkelje të Ligjit Penal dhe t`a anuloj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, me të cilin të mbrojturit të tij i është vazhduar masa e arrestit shtëpiak dhe të njëjtit t`ia ndërpres menjëherë këtë masë.

Prokurori i Shtetit të Kosovës me shkresën KMLP.III.nr.189/2024 të datës 16.07.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit të hidhet si e pa pranueshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 2 të KPP-së, i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e papranueshme.

Me dispozitën e nenit 432, paragrafi 4 të KPP-së, përcaktohet se *“kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet gjatë procedurës penale e cila nuk ka përfunduar në formën e prerë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin ose vazhdimin e paraburgimit”*. Andaj, duke e pasur për bazë faktin se në rastin konkret kemi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktvendimeve me të cilat është vazhduar masa e arrestit shtëpiak, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se e njëjta është e pa pranueshme.

Duke u bazuar në këto që u theksuar në më lart dhe në bazë nenit 435, paragrafi 2 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
PML.nr.446/2024, më datë 17.07.2024

Procesmbajtës,
Sherif Krasniqi

Kryetar i kolegjit,
Afrim Shala